



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 10 datë 30/01/1998.

PER
DHENIE FOND PAGE NDERMARRJES SE PRODHIMIT TE ENEVE
TE BAKRIT PER SISTEMIMIN DHE ARKIVIMIN E
DOKUMENTACIONI.

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjene tij të dt.30.01.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Industrisë, “Për dhënie fond page ndërmarrjes së prodhimit të enëve të bakrit për sistemimin dhe arkivimin e dokumentacionit”, mbështetur në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, duke zbatuar vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.589, dt.16.10.1995, pika.IV (6)

V E N D O S I

1. Për sistemimin e dokumentacionit të Ndërmarrjes për arkivim, të paguhet likuidatori për 15 ditë, paga **6.000** lekë.
2. Për shpenzimet e dërgimit të dokumentacionit në arkivë(për mjete transporti dhe për puntorë ngarkim-shkarkimi të dokumentave), miratohet paga **5.000** lekë.

Shuma totale = 11.000 lekë.

3. Fondi i pagës të nxirret në Janarin 1998.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI